

## 1. Informacion i përgjithshëm

I.C.P Shpk është krijuar me datë 04/01/2019 dhe është rregjistruar me QKR Date 10/01/2019. Statusi juridik Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar.

Kapitali themeltar i shoqërisë është 1000 Lekë dhe Z. Alban Dautaj zotëron 100% të kuotave të kapitalit.

Selia e entitetit ndodhet në Durres, Durres Durres DURRES Lagjja nr.18, Rruga AleksandërGoga, Pallati 788, Shk.1, K.1, Ap.2, Pasuria numër 29/70+1-211, Zona Kadastrale 8511.

Objekti i veprimtarisë është Projektim, zbatim të objekteve civile, industriale, objekte të infrastrukturës rrugore, ura, tunele, vepra arti, sinjalistikë. Objekte hidroteknike të infrastrukturës ujore, ujësjellës, kanalizime, impiante të kanalizimit të ujit, impiante të prodhimit, të transmetimit dhe transformimit të fuqisë linja të TU, TM, TL. Infrastrukturë urbane, rrjete inxhinierike, plane rregullues e studime urbanistike pjesore. Impiante të prodhimit të materialeve të ndërtimit. Kryerje, vlerësime, studime mjedisore për të gjitha llojet. Shërbime konsulence për punim, ndërtim, montim të objekteve civile, veprave inxhinierike dhe menaxhimit të investimeve. Tregtim të materialeve dhe pjesëve hidraulike, elektrike, drusore, lëndësh të para për inerte nën e mbi tokë, etj. Vlerësimin e pasurive të paluajtshme, vlerësime dëmsh, etj. Projektme në fushën hidroteknike, të arkitekturës, urbanistikës, etj. Mirëmbajtje, sinjalizime mbi shtesa rrugore. Import, eksport, tregti me shumicë e pakicë mallrash të ndryshme, hidraulike, mekanike, reagent laboratorike, makineri e pajisje, mjete transporti, mallra e pajisje elektrike e elektroshtëpiake, industriale, ushqimore e veshmbathje, fruta, perime, furnizime e pije të ndryshme. Shërbime IT. Mirëmbajtje e aparateve, pajisje teknike, veglave të punës. Ushqimore të ndryshme, mish, bulmet, fruta, perime, etj. Shoqëria mundet gjithashtu të kryejë edhe çdo aktivitet tjetër të nevojshëm apo të dobishëm për përmbushjen e objektit të sipërtreguar. Tregtim i materialeve për dezinfektim, higjenezim, klor plihur, klor leng, klor për uje te pishem, sherbime DDD. Servis automjetesh dhe makinerive te renda.

Veprimtaria e entitetit rregullohet me:

- Statut
- Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët Shoqëritë Tregtare",
- Ligji Nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", ndryshuar me Ligjin Nr. 9477, datë 09.02.2006,
- Legjislacioni Fiskal,
- Akte të tjera ligjore e nënligjore të shtetit Shqiptar.

Drejtimi realizohet nga asambleja e përgjithshme, atributet e së cilit i ushtron ortaku i vetëm ,njekohesisht edhe administrator i shoqërisë Z. Alban Dautaj

Qarkullimi vjetor 65,821,228, mijë Lekë (afarizmi).

## 2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

### 2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.9228, datë 29 prill 2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

Në bazë të urdhrit nr. 64 datë 22.07.2014 "Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre", Ministria e Financave vendosi të bëjë të detyrueshëm zbatimin e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara duke filluar nga 1 janar 2015.

Ky urdhër hyri në fuqi me fletoren zyrtare nr.119, datë 1 gusht 2014.

### 2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

### 2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

### 2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lekë, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

## 2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që menaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël. Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste menaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Menaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas perkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale.

Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

### 2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pamundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Menaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

### 2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Menaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

### 2.5.3. Krahasueshmeria e informacionit kontabël

Siç paraqitet në Standartin Kombëtar të Kontabilitetit të përmirësuar nr.1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standarti të ri, një përmirësim në standart apo një ndryshim në ligjin "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përveç rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk rri në vlerësohet në mënyrë të besueshme.

## 3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

### 3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe rregjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetare është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jomonetare në monedhe të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja me 31 Dhjetor 2022 dhe 2021 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	<u>31 Dhjetor 2023</u>	<u>31 Dhjetor 2022</u>
EUR/LEK	103.88	114.23

USD/LEK

93.94

107.05

### 3.2. Instrumentat Financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë.

Për instrumentat e mbajtur me vlere të drejte nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë:

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivët financiarë çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të Shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa rmbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën Shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të Shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

#### *Mjetet monetare*

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhesë dhe depozitat në para me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

#### *Llogari të arkëtueshme*

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

#### *Llogari të pagueshme*

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

#### *Hua të marra dhe të dhëna*

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

#### *Vlera e drejtë*

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalenteve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

#### *Të tjera*

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

#### *Zhvlerësimi i aktiveve financiarë*

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktiviteti.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

“I.C.P” Shpk  
Shënime për pasqyrat financiare  
Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2022 dhe 31 Dhjetor 2023

(Të gjitha balancat janë në lekë)

Aktivitetet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivitetet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivitetet financiare të matura me kosto të amortizuara, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

### 3.3. Inventarët

Inventarët rregjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar. Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën me të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

### 3.4. Aktive afatgjata materiale

#### *Njohja dhe matja*

Të gjitha aktivitetet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitetit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitetit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitetit kur përfundon ndërtimi i tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktiviteti afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

#### *Kostot e mëpasshme*

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

#### *Amortizimi*

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktiviteti afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2023 dhe 2022 është si mëposhtë:

<b>Kategoria e aktiveve</b>	<b>Metoda e Amortizimit</b>	<b>Norma e amortizimit</b>
Mobilje për zyrën	Vlera e mbetur	20%
Pajisje informatike	Vlera e mbetur	25%
Të tjera aktive afatgjata	Vlera e mbetur	20%
Pajisje për zyrën	Vlera e mbetur	20%
Autovetura	Vlera e mbetur	20%

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çrregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

### **3.5. Të ardhurat**

Të ardhurat rregjistrohen sipas masës së realizimit të tyre dhe lidhjes që ato kanë me ushtrimin e mbyllur kontabël, pavarësisht nëse arkëtimi i tyre apo i një pjese prej tyre do të ndodhë në një ushtrim pasardhës.

Të ardhurat janë përfitimet ekonomike bruto (pa TVSH dhe zbritjet tregtare), të marra gjatë periudhës kontabël, si rezultat i rrjedhës normale të veprimtarisë së njësisë ekonomike raportuese, atëherë kur këto përfitime ekonomike çojnë në rritjen e kapitaleve të veta.

### **3.6. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit**

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjatë të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

### **3.7. Qiratë**

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare rregjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me format e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve. Shoqëria ka vetëm qira operative.

### **3.8. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare**

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

### **3.9. Tatimi mbi fitimin**

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2023 është 15% (2022: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimin të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyre njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Shoqëria nuk ka burim diferencash të përkohshme për njohjen e tatimit të shtyrë.

### **3.10. Fondet për pensione**

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

“I.C.P” Shpk  
Shënime për pasqyrat financiare  
Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2022 dhe 31 Dhjetor 2023

(Të gjitha balancat janë në lekë)

### 3.11. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

### 3.12. Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

## 4. Mjete monetare

Mjetet monetare në arkë dhe në bankë më 31 Dhjetor 2023 dhe 31 Dhjetor 2022 detajohen si mëposhtë:

	<u>31 Dhjetor 2023</u>	<u>31 Dhjetor 2022</u>
Arka	80,819	606,385
Banka	20,222,797	2,318,327
	<u>20,303,616</u>	<u>2,924,712</u>

## 5. Të drejta të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme më 31 Dhjetor 2023 dhe 31 Dhjetor 2022 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2023</u>	<u>31 Dhjetor 2022</u>
Kliente për mallra, produkte e shërbime	107,036,933	90,116,036
	<u>107,036,933</u>	<u>90,116,036</u>

## 6. Të tjera të arkëtueshme

Gjendja e llogarive të tjera të arkëtueshme më 31 Dhjetor 2023 dhe 31 Dhjetor 2022 paraqitet si vijon:

	<u>31 Dhjetor 2023</u>	<u>31 Dhjetor 2022</u>
Tvsh	1,665,843	6,984,209
Tatim fitimi	8,660,256	2,873,998
	<u>10,326,099</u>	<u>9,858,207</u>

## 7. Inventari

Gjendja e inventarit më 31 Dhjetor 2022 dhe 31 Dhjetor 2021 detajohet si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2023</u>	<u>31 Dhjetor 2022</u>
Materiale të para	25,128,607	13,503,043
	<u>25,128,607</u>	<u>13,503,043</u>

## 8. Shpenzime të shtyra

“I.C.P” Shpk  
Shënime për pasqyrat financiare  
Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2022 dhe 31 Dhjetor 2023  
(Të gjitha balancat janë në lekë)

---

	<u>31 Dhjetor 2022</u>	<u>31 Dhjetor 2021</u>
Shpenzime te periudhave te ardhshme	<u>0</u>	<u>0</u>
	<u><b>0</b></u>	<u><b>0</b></u>

**9. Lëvizja e aktiveve të qëndrueshme dhe amortizimi**

Nr	Nr.artikuli	Pershkrimi	Njesia	Gjendje	Muaj	Vlefte 01.01.2023	Norma	Amortizimi	Gjendja 31.12.2022
213	A001	EKSKAVATOR	cope	1.00	12.00	955,733	20%	191,147	764,586
2181	A002	KOMPJUTERA	cope	6.00	12.00	93,417	25%	23,354	70,063
2181	A003	PRINTER	cope	2.00	12.00	7,141	25%	1,785	5,356
2181	A004	MOBILJE PER ZYREN	cope	17.00	12.00	212,528	20%	42,506	170,022
213	A007	MAKINERI NGJITJE TUBI	cope	1.00	12.00	90,360	20%	18,072	72,288
213	A008	APARAT INSPEKTIMI PER RRJETET E UJESJELLESIT DHE KABUJVE (RIDGID SR-24)	cope	1.00	12.00	273,600	20%	54,720	218,880
213	A009	APARAT NGJITJE PPR	cope	4.00	12.00	5,760	20%	1,152	4,608
215	A010	AUTOMJET IVECO-MARIGUS	cope	1.00	12.00	385,162	20%	77,032	308,130
213	A011	KOMPRESOR 50L	cope	1.00	12.00	5,555	20%	1,111	4,444
213	A012	BOT	cope	1.00	12.00	196,000	20%	39,200	156,800
213	A013	DAIMLER CHRYSLER AA 478 UB	cope	1.00	12.00	136,111	20%	27,222	108,889
213	A014	TESTUES BATERIE ME PRINTER TERMIK	cope	1.00	12.00	19,349	20%	3,870	15,479
213	A015	MOTORRSHARRE LAME 40CM	cope	1.00	12.00	24,111	20%	4,822	19,289
213	A016	KAMION ME VINC	cope	1.00	12.00	1,164,903	20%	232,981	931,922
2181	A017	TELEVIZOR 32 SMART	cope	1.00	12.00	16,667	20%	3,333	13,333
2182	A0032	IPHONE 14 PRO MAX	cope	1.00	6.00	150,000	<b>25%</b>	18,750	131,250
213	A026	GJENERATOR INDA 4000 4.2KVA 230VOLT	cope	1.00	10.00	28,164	<b>20%</b>	4,694	23,470
215	A027	VETUR BENZ TIP GL 320	cope	1.00	8.00	320,000	<b>20%</b>	42,667	277,333



“I.C.P” Shpk  
 Shënime për pasqyrat financiare  
 Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2022 dhe 31 Dhjetor 2023

(Të gjitha balancat janë në lekë)

21501	A028	FADROME	cope	1.00	3.00	2,772,380	<b>20%</b>	138,619	2,633,761
2188	A029	SAMSUNG GALAXY A14 4/128GB BLACK	cope	1.00	6.00	18,325	<b>25%</b>	2,291	16,034

**10. Llogaritë e pagueshme ndaj furnitorëve**

Llogaritë e pagueshme ndaj furnitorëve më 31 Dhjetor 2023 dhe 31 Dhjetor 2022 paraqiten si mëposhtë:

	<u>31 Dhjetor 2023</u>	<u>31 Dhjetor 2022</u>
Te pagueshme ndaj furnitoreve	37,531,964	23,218,483
	<u><b>37,531,964</b></u>	<u><b>23,218,483</b></u>

**11. Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore**

Detyrimet ndaj punonjësve dhe Institutit të Sigurimeve Shoqërore detajohen si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2023</u>	<u>31 Dhjetor 2022</u>
Detyrime ndaj punonjësve	(10)	499,069
Detyrime per sigurime shoqërore e shendetesore	301,046	216,945
	<u><b>301,037</b></u>	<u><b>716,014</b></u>

**12. Te tjera detyrime afatshkurtra**

Detyrimet e tjera afatshkurtra detajohen si më poshtë per vitin e mbyllur përkatësisht me 31 Dhjetor 2023 dhe 31 Dhjetor 2022:

	<u>31 Dhjetor 2023</u>	<u>31 Dhjetor 2022</u>
Te tjera detyrime afatshkurtra	1,000,000	0
	<u><b>1,000,000</b></u>	<u><b>0</b></u>

**13. Detyrime ndaj Institucioneve të Kredisë**

Detyrimet ndaj institucioneve bankare për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2022 dhe 31 Dhjetor 2021 detajohen si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2023</u>	<u>31 Dhjetor 2022</u>
Debitore/Kreditore te tjere	46,923,818	26,078,818
	<u><b>46,923,818</b></u>	<u><b>26,078,818</b></u>

**14. Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit**

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit me 31 Dhjetor 2023 dhe 31 Dhjetor 2022 detajohen si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2023</u>	<u>31 Dhjetor 2022</u>
Te ardhura nga shitja e punimeve dhe sherbimeve	62,821,228	24,117,281
Te ardhura ga shitja e mallrave	3,568,000	1,166,225
Te ardhura nga qirate	0	0
Te ardhura te tjera	94,050	977,200
	<u><b>65,915,278</b></u>	<u><b>26,260,706</b></u>

**15. Shpenzime për mallra, lëndë të parë dhe materiale**

Shpenzime për blerje të lëndës së parë detajohen si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2023</u>	<u>31 Dhjetor 2022</u>
Blerje /shpenzime te materialeve te tjera	31,197,527	15,829,099
Blerje /shpenzime mallra, sherbimesh	5,951,864	6,695,149
	<u><b>37,149,391</b></u>	<u><b>22,524,248</b></u>

**16. Kosto e personelit**

Pagat e personelit dhe sigurimet më 31 Dhjetor 2023 dhe 31 Dhjetor 2022 detajohen si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2023</u>	<u>31 Dhjetor 2022</u>
Pagat e personelit	10,944,574	9,305,091
Sigurimet shoqerore e shendetesore	1,827,746	1,577,802
	<u><b>12,772,320</b></u>	<u><b>10,882,893</b></u>

“I.C.P” Shpk  
 Shënime për pasqyrat financiare  
 Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2022 dhe 31 Dhjetor 2023

(Të gjitha balancat janë në lekë)

**17. Shpenzime të tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit**

Shpenzimet e tjera të veprimtarisë së shfrytëzimit më 31 Dhjetor 2023 dhe 31 Dhjetor 2022 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2023</u>	<u>31 Dhjetor 2022</u>
Bl.energji,avull,uje	52,050	44,733
Te tjera	31,197,527	14,784,366
Personel nga jashte ndermarjes	1,323,609	1,262,580
Sherbime bankare	990,691	110,081
Te tjera tatime e taksa	12,844	793,598
Shpenzime te tjera	57,083	122,110
Tatim /Taksa	61,706	74,886
	<u><b>1,554,303</b></u>	<u><b>2,363,255</b></u>

**18. Të ardhura dhe shpenzime të tjera financiare**

	<u>31 Dhjetor 2023</u>	<u>31 Dhjetor 2022</u>
Te ardhura nga interesat	-	11,467
Shpenzime nga interesat	-	(22,877)
	-	<b>(11,410)</b>
Diferenca pozivite nga kursi i kembimit	-	-
Diferenca negative nga kursi i kembimit	-	-
	<u>-</u>	<u>-</u>

**19. Rezultati i vitit**

	<u>31 Dhjetor 2022</u>	<u>31 Dhjetor 2021</u>
Fitimi/(Humbja) para tatimit	13,509,935	(10,176,327)
Shpenzime te pazbritshme:		
Gjoha e penalitete	-	-
Te tjera	-	-
Humbje e mbartur	(10,176,327)	
<b>Fitimi I tatueshem</b>	<b>3,333,608</b>	<b>(10,176,327)</b>
Tatim Fitimi	500,041	-
<b>Fitimi/Humbja pas tatimit</b>	<u><b>2,833,567</b></u>	<u><b>(10,176,327)</b></u>

**20. Ngjarje pas datës së bilancit**

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në keto pasqyra financiare.

---

**Ideal Construction and Projection (ICP)**

Durrës më 31.Mars 2023

---

**Perfaqesues ligjor**

Alban Dautaj